

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Afati deri më 6 tetor, presioni mbi partitë: marrëveshje për Presidentin apo zgjedhje të reja?
ADRESA	https://albeu.com/kosove/afati-deri-me-6-tetor-presioni-mbi-partite-marreveshje-per-presidentin-apo-zgjedhje-te-reja/1027408/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 15:10:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 15:08:17 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6f5ef8aa8c0a4d0d394de04bf9fd861e8bda795fe0d9302e8d165a55ea4ef3ac
TEKSTI	3b833803591f7c9ca0fba73d14de7d58546ba43e175b49db53c56f806189232c
PAMJA	0ce00609158e24d591c9ed06e0f5c3c926667d3bf2da7be0745d7d1da3a7a19b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	72037dd20bf2fac765f80e8f9d670a4cb974a2f7569640c63ab9c6e612912093
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a8b637500bb34dd44849ee47713c862e0f86b2067940dc4d517e848dfddb5dc3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/72037dd20bf2fac765f80e8f9d670a4cb974a2f7569640c63ab9c6e612912093>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Afati deri më 6 tetor, presioni mbi partitë: marrëveshje për Presidentin apo zgjedhje të reja?



Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka vlerësuar të mërkurën se Kuvendi është konstituuar, pavarësisht se kjo është bërë pas përfundimit të afatit 30-ditor. Sipas saj, edhe zgjedhja e Qeverisë është zhvilluar në pajtim me Kushtetutën.

Vendimi përcakton se afati 60-ditor për zgjedhjen e Presidentit ka nisur më 8 gusht 2026 dhe përfundon më 6 tetor 2026. Kjo i lë Kuvendit kohë deri në këtë datë për të zgjedhur kreun e shtetit.

"Afati gjashtëdhjetë (60)-ditor për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës, sipas nënparagrafit 3, paragrafit 1 të nenit 82 [Shpërndarja e Kuvendit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ka filluar më 8 gusht 2026 dhe përfundon më 6 tetor 2026", thuhet në njoftimin e Gjykatës Kushtetuese.

Analistët politikë e konsiderojnë të shkurtër kohën e mbetur, por thonë se marrëveshja mund të arrihet nëse partitë e kuptojnë se ekziston formula për zgjedhjen e Presidentit dhe tregojnë vullnet për ta zbatuar atë. Sipas tyre, ende ka hapësirë për mirëkuptim dhe kompromis.

Problemi politik dhe mundësia e kompromisit

Analisti politik Lirim Gashi thotë se 11 ditë nuk janë shumë për të arritur një marrëveshje politike, por vlerëson se gjithçka varet nga vullneti i palëve.

të fundit /



Afati deri më 6 tetor, presioni mbi partitë: marrëveshje për...



Rast shqetësues në një shkollë në Itali: 6-vjeçarit i zbulohet në...



Rama në Nju Jork: Shqipëria po krijon imunitet ndaj...



Tre të plagosur pas përplasjes së dy makinave në aksin...



Acibadem Sistina realizon dy ndërhyrje gjinekologjike robotik...



GM përgatit motorin e ri V8 me naftë, me 555 kuaj/fuqi



Organizatrat kosovare i kërkojnë Amnesty International të...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium



Sipas tij, çështja nuk ka të bëjë me mungesë të një formule matematikore, por me pengesa politike.

"Nuk do të përpiquesha të parashikoja rezultatin e negociatave duke iu drejtuar ndonjë 'fallxhori politike'. Në Kosovë, madje edhe parashikimi i motit duket më i lehtë sesa të merret me mend se si do të votojë një deputet kur ndodhet përpara kutisë së votimit", deklaroi Gashi për "Bota sot".

Ai shton se, megjithëse 11 ditë janë pak për politikën kosovare, kjo periudhë mund të jetë e mjaftueshme nëse palët e dëshirojnë realisht marrëveshjen.

Gashi thekson se zgjedhja e Presidentit kërkon mbështetje të gjerë parlamentare. Në dy raundet e para nevojitet shumica prej dy të tretash, ndërsa në raundin e tretë votohet mes dy kandidatëve më të votuar dhe kërkohet shumica e të gjithë deputetëve.

"Formula kushtetuese ekziston. Ajo që mungon shpesh është gatishmëria për ta përdorur atë, pa e kaluar fillimisht çdo mundësi në filtrin e interesit partiak. Presidenti nuk duhet të zgjidhet si kryetar partie, por si përfaqësues i shtetit. Nëse kjo kuptohet gjatë këtyre ditëve, marrëveshja mbetet e mundshme. Nëse Presidenca shihet si trofe i përplasjes partiake, atëherë as 13 muaj nuk do të mjaftonin", shprehet ai.

Analisti thotë se hapësira për kompromis është e pranishme, por mbetet e paqartë nëse partitë do të jenë të gatshme ta bëjnë atë.

Sipas Gashit, kompromisi do të nënkuptonte pranimin e parimit se Presidenti nuk është shpërblim për subjektin që ka më shumë deputetë dhe as ndëshkim për atë që ka më pak. Ai është institucion i shtetit.

"Partitë në Kosovë shpesh pranojnë të bëjnë kompromis me realitetin, por e kanë më të vështirë të gjejnë gjuhën e përbashkët me njëra-tjetrën. Tani, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, afati është konkret: ai ka nisur më 8 gusht dhe mbyllet më 6 tetor 2026", thotë Gashi.

Ai vlerëson se përgjegjësia tani ndodhet te liderët politikë, të cilët duhet të vendosin nëse stabiliteti institucional do të arrihet përmes një marrëveshjeje reale.

"Nëse palët pranojnë se Presidenti është institucion i shtetit dhe jo çmim për partinë më të madhe, atëherë ekziston terren për marrëveshje. Në të kundërt, vendi mund të përballet me një tjetër kapitull të krizës politike", shprehet ai.

Një kandidat jashtë strukturave partiake, sipas Gashit, mund të ndihmonte në uljen e tensioneve mes subjekteve politike.

"Kandidati duhet të vlerësohet jo nga pyetja se cilës parti i përket, por nga ajo se çfarë përfaqëson. Nëse lidhet vetëm me një subjekt politik, atëherë kemi të bëjmë me kandidat partiak. Nëse përfaqëson shtetin, Kushtetutën dhe interesin publik, atëherë mund të konsiderohet kandidat presidencial", thekson ai.

Sipas tij, një figurë e tillë duhet të ketë integritet publik, kredibilitet institucional, përvojë dhe aftësi për të komunikuar me kampe të ndryshme politike, pa u shndërruar në përfaqësues të ndonjërit prej tyre.

"Një figurë jopartiake mund të ndihmojë pikërisht sepse do ta ulte temperaturën politike. Megjithatë, në Kosovë edhe një person i pavarur shpesh bëhet objekt dyshimesh se nga cila parti është i pavarur. Kandidati duhet të jetë më i madh se marrëveshja që e sjell në Presidencë. Kreu i shtetit duhet të simbolizojë unitetin e qytetarëve dhe jo një pazar politik", deklaroi Gashi.

Duke folur për pasojat në rast se Presidenti nuk zgjidhet brenda afatit kushtetues, ai kujton se neni 82 parashikon shpërndarjen e Kuvendit nëse kreu i shtetit nuk zgjidhet brenda 60 ditësh nga nisja e procedurës.

Ndërkohë, neni 86 përcakton se, nëse kandidati nuk merr votat e nevojshme as në raundin e tretë, Kuvendi shpërndahet dhe zgjedhjet e reja duhet të zhvillohen brenda 45 ditësh.

"Dështimi nuk do të ishte vetëm një debat tjetër televiziv, ku palët fajësojnë njëra-tjetrën. Pasoja do të ishte institucionale: shpërndarja e Kuvendit dhe hapja e rrugës për zgjedhje të reja parlamentare", shpjegon Gashi.

Ai e cilëson paradoksale mundësinë që Kosova të votojë sërish për një Kuvend të ri, i cili do të përballej përsëri me të njëjtin problem që organi aktual nuk arriti ta zgjidhte.

"Çështja kryesore nuk është vetëm nëse partitë do të gjejnë marrëveshje për Presidentin, por nëse politika kosovare do të jetë në gjendje të dallojë kompromisin nga dorëzimi dhe parimin nga interesi partiak. Demokracia nuk kërkon që partitë të kenë të njëjtin qëndrim, por kërkon që, kur bëhet fjalë për shtetin, të mos mendojnë vetëm për veten", përfundon analisti.

Ngërçi politik dhe përgjegjësia e partive

Analisti politik Milazim Maraj e sheh situatën si pasojë të zgjedhjeve që, sipas tij, nuk kanë sjellë zgjidhje, por kanë prodhuar bllokim institucional.

Ai i akuzon LVV-në dhe LDK-në për paaftësi për të gjetur një gjuhë të përbashkët.

"Kosova po përballët me zgjedhje të jashtëzakonshme që nuk po sjellin zgjidhje, por ngërçe. Kjo sjellje, sipas tij, lidhet me këmbënguljen politike, mbrojtjen e paligjshmërisë së mëhershme dhe interesat e grupeve të caktuara që mund të druhen nga humbja e përfitimeve të kundërligjshme", shprehet Maraj për "Bota sot".



Ai pretendon se disa parti mund të jenë të ndikuara nga forca kriminale jashtë vendit dhe kritikon mënyrën e veprimit të Albin Kurtit, duke thënë se kushtet e vendosura prej tij, së bashku me ofendimet dhe përçmimet, kanë ndikuar në krijimin e një atmosfere jo bashkëpunuese.

Sipas Marajt, paaftësia e kryetarit të LVV-së për të ndërtuar një gjuhë të përbashkët për krijimin e institucioneve të Kosovës duhet të analizohet thellë, pasi mbetet e paqartë nëse bëhet fjalë për paaftësi apo për një porosi politike.

Sa i përket LDK-së, ai e përshkruan si parti të përçarë dhe thotë se një situatë e tillë ishte e pritshme. Sipas tij, vetëm pas zgjedhjeve brenda partisë mund të pritet një kontribut më demokratik dhe më i dobishëm i LDK-së për vendin.

Maraj thotë se PDK-ja dhe AAK-ja po përpiqen të ruajnë pozicionet e tyre dhe paralajmëron se vendi ndodhet pranë një situatë anarkie, e cila, sipas tij, do t'i shkaktojë Kosovës dëme të mëdha.

Ai i kritikon këto dy parti për protestat kundër vendimit të Gjykatës Speciale, duke pretenduar se ato janë të informuara se veprimet e tilla nuk ndihmojnë të dënuarit, por ua vështirësojnë çështjen dhe dëmtojnë imazhin e Kosovës në botë.

"Në vend që të përgatiten për apel dhe të paraqesin argumente të reja, ato po shantazhojnë nga rruga. Kjo mund të jetë mungesë dijeje ose qëllim i keq", deklaroi Maraj.

Sipas tij, moszgjedhja e Presidentit është nxitur nga inati politik dhe po ndodh në dëm të qytetarëve që u kanë besuar përfaqësuesve të tyre.

"Kosova ka votuar për një shtet demokratik. Centralizimi i pushtetit në emër të numrit të votave është totalitarizëm dhe këtë, sipas tij, e kuptojnë të gjithë. Afati për kompromis mes partive është i shkurtër, por vetë partitë e kanë sjellë situatën në këtë pikë, pasi nuk e shfrytëzuan kohën që kishin pas zgjedhjeve", thekson ai.

Maraj paralajmëron se zgjedhjet e tjera të jashtëzakonshme mund të sjellin sërish kushte të jashtëzakonshme dhe të ulin pjesëmarrjen e qytetarëve, të demoralizuar nga sjellja e të zgjedhurve.

"Pas tri palë zgjedhjesh, qytetarët nuk do të binden më nga përpjekjet për t'ia kaluar fajin opozitës. Ka pasur mundësi të mjaftueshme për krijimin e institucioneve, por koha është harxhuar me spektakle rreth gjetjes së një Presidenti konsensual", thotë ai.

Analisti nënvizon se bllokimi ka sjellë edhe pasoja në arenën ndërkombëtare, duke përmendur mungesën e përfaqësimit të Kosovës në OKB.

"Kosova mbeti pa zë në OKB dhe nuk pati kush t'u kundërvihej gënjeshtërve serbe. Vuçiq mbajti ligjëratë morale në mungesë të Presidentit të Kosovës. Kjo duhet të ndikojë në ndërgjegjen e atyre që morën besimin e qytetarëve, por e keqpërdorën atë", shprehet Maraj.

Ai ngre pyetjen se në interes të kujt po veprohet dhe thotë se vendi është shumë pranë anarkisë, ndërsa në horizont nuk sheh ndonjë veprim shpresëdhënës për tejkalimin e krizës.

Maraj pretendon gjithashtu se Albin Kurti nuk pranohet në OKB gjatë qëndrimit në SHBA, por zhvillon fushatë zgjedhore. Sipas tij, qytetarët tashmë janë detyruar të kërkojnë unitet mes politikanëve, në vend që të kërkojnë përgjegjësi prej tyre.

"Koha për mirëkuptim dhe kompromis ende ekziston. Por kjo është nëse ka vullnet dhe përgjegjësi, si dhe nëse

...koha për mirëkuptim dhe kompromis ende ekziston. Një gjë është nëse ka vullnet dhe përgjegjësi, si dhe nëse respektohet gjaku dhe sakrifica e të rënëve, në emër të të cilëve është bërë thirrje gjatë fushatave", thotë ai.

Ai pyet se kush po e shkel sakrificën e dëshmorëve: Gjykata Speciale apo ata që vazhdojnë të mbajnë zgjedhje të jashtëzakonshme dhe nuk arrijnë të merren vesh mes vete për të mirën e vendit.

"Nëse zhvillohen sërish zgjedhje të jashtëzakonshme, do të krijohen edhe një herë rrethana të jashtëzakonshme. Megjithatë, koha për kompromis nuk ka përfunduar. Mbetet të shihet nëse partitë kanë vullnetin dhe përgjegjësinë për ta shfrytëzuar atë", përfundon Maraj.

Shtuar më 25.09.2026 17:08

Tags: [kuvendit](#), [Lirim Gashi](#), [Milazim Maraj](#), [presidentin](#), [zgjedhje](#)



Nis mbledhja e Këshillit Drejtues të PDK-së



Organizatrat kosovare i kërkojnë Amnesty International të përfshijë...



Çlirim Haziri fton qytetarët të vendosin flamujt e UÇK-së në shtëpitë e tyre



Rukiqi kërkon sqarime për importin e produkteve braziliane: Pse Kosova n...



I kërkohet Avokatit të Popullit ta dërgojë Ligjin për Specialet në Kushtetuesë



Gërvalla: Projektligji për Byronë i është dërguar Zyrës së Kryeministrit



Nagavci: Kanë mbetur 11 ditë për zgjedhjen e presidentit, nevojitet qasj...



Haxhiu: Familjarët e Thaçit, Veselit dhe Krasniqit nuk e pranian ftesën për takim



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com